



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

VENDIM

Nr. 245, datë 30.06.2022

PËR

**CAKTIMIN E GJYQTARIT TË SKEMËS SË DELEGIMIT
Z. {...}, PËR GJYKIMIN E NJË ÇËSHTJEJE GJYQËSORE
NË GJYKATËN E POSAÇME TË APELIT PËR KORRUPSIONIN
DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, të pikës 4 dhe pikën 7, të nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 13, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me Shkresën nr. 514 prot., datë 27.06.2022, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3686 prot., datë 29.06.2022, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mbas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}, Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 189/2, 190/2, 298/2-28/4, 333/a2, 334/1 Kodit Penal”.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR